



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR
BASHKËPUNIMIN, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
EUROJUST-IT**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 13.12.2018, me cilësinë e **Komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”*

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Drejtësisë e përfaqësuar nga Znj. Etilda Gjonaj, Minister.

1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it. Kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor, si dhe lehtësimin e bashkërendimit të hetimeve e të ndjekjeve penale, që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve anëtare të Bashkimit European. Objektivat specifik të kësaj marrëveshje janë:

- Fuqizimi i bashkëpunimit në luftën kundër krimeve të rënda, veçanërisht krimit të organizuar dhe terrorizmit;
- Bashkërendimi dhe financimi i veprimeve hetimore të përbashkëta, njëkohësisht me financim të BE-së, nëpërmjet skuadrave hetimore të përbashkëta;
- Garantimi i një niveli të lartë mbrojtjeje të të dhënave personale nga palët, në respektim të Konventës së Këshillit të Europës Nr.108, datë 28 janar 1981 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, të drejtave themelore dhe parimeve të përcaktuara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Këshillit të Europës, të datës 4 nëntor 1950, të cilat janë reflektuar edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, si dhe të parimeve të përcaktuara në aktet e tjera të BE-së dhe të Eurojust-it për mbrojtjen e të dhënave personale.

Eurojust-i është një strukturë e BE-së e bashkëpunimit gjyqësor, e krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit 2002/187/DÇB të datës 28 shkurt 2002¹ (Vendimi i Eurojust-it), për të nxitur dhe përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve gjyqësore kompetente të Shteteve Anëtare të BE-së, në veçanti për të luftuar krimin e rëndë të organizuar. Eurojust përbëhet nga prokurorë kombëtarë, magjistratë ose oficerë gjyqësorë me kompetencë ekuivalente, sipas legjislacionit të secilit Shtet Anëtar.

Marrëveshja me Eurojust-in do të kontribuojë në realizimin e pesë prioritetëve të vendosura nga Komisioni Evropian ndaj Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në kuadër të prioritetit të katërt “Lufta kundër krimit të organizuar”.

Prokuroria e Përgjithshme është institucioni shqiptar që ngarkohet me zbatimin e marrëveshjes. Për të lehtësuar bashkëpunimin e parashikuar në këtë marrëveshje, shteti shqiptar mund të komandojë një prokuror ndërlidhes pranë Eurojust-it (neni 5 i marrëveshjes). Prokurori ndërlidhës i komanduar, i nënshtrohet ligjit shqiptar në lidhje me statusin, mandatin, kompetencat dhe kohëzgjatjen e komandimit të tij. Gjithashtu shteti shqiptar duhet të caktojë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, një prokuror si pikë kontakti e Eurojust-it (neni 7 i marrëveshjes).

2. Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me prioritetet e parashikuara në **PKIE 2018 - 2020, Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”**.

3. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të Projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

- Legjislacioni parësor i BE-së:

Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit European (**TFBE**): **Neni 85** (ish-neni 31 TBE), Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri (**MSA**): Titulli VII “Liria, Drejtësia dhe Siguria”, **Neni 78** “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, **Neni 82** “Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, **neni 83** “Bashkëpunimi kundër drogave të paligjshme”, **Neni 84** “Bashkëpunimi kundër terrorizmit”, **Neni 85** “Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme”.

- Legjislacioni dytësor i BE-së:

Vendimi i Këshillit 2002/187/DÇB, datë 28 shkurt 2002 që krijon Eurojust-in me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të rëndë (Vendimi i Eurojust-it), i ndryshuar me Vendimet e Këshillit 2003/659/ DÇB dhe 2009/426/ DÇB dhe i shfuqizuar nga Rregullorja (BE) 2018/1727, me efekt nga data 12 dhjetor 2019.

Rregullorja (BE) 2018/1727 e Parlamentit European dhe Këshillit, datë 14 nëntor 2018 “Mbi Agjensinë e Bashkimit European për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale (Eurojust), që zëvendëson dhe shfuqizon Vendimin e Këshillit 2002/187/ DÇB” (Rregullorja e Eurojust-it), e cila do të hyjë në fuqi në datën 12 dhjetor 2019.

Neni 85 i TFBE-së parashikon se misioni i Eurojust-it është të mbështesë dhe forcojë bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare të hetimit dhe të ndjekjes

¹ I ndryshuar me Vendimet e Këshillit 2003/659/ DÇB dhe 2009/426/ DÇB, si dhe i shfuqizuar nga Rregullorja (BE) 2018/1727, me efekt nga data 12 dhjetor 2019.

[Type here]

penale lidhur me krimet e rënda që prektin 2 ose më shumë Shtete Anëtare të BE-së ose që kërkojnë ndjekje penale mbi baza të përbashkëta, mbështetur në operacionet e zhvilluara dhe informacionet që kanë dhënë autoritete e Shteteve Anëtare dhe dhe Europol-i.

Neni 78 i MSA-së parashikon bashkëpunimin mes palëve në forcimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës. Gjithashtu **nenet 82-85 të MSA-së** parashikojnë bashkëpunimin e palëve në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, drogave të paligjshme, terrorizmit, krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme.

Vendimi i Eurojust-it i datës 28 shkurt 2002 krijoi Eurojust-in si një strukturë e BE-së e bashkëpunimit gjyqësor, për të nxitur dhe përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve gjyqësore kompetente të Shteteve Anëtare të BE-së, në veçanti për të luftuar krimin e rëndë të organizuar. Ky vendim është ndryshuar me Vendimet e Këshillit 2003/659/ DÇB dhe 2009/426/ DÇB. **Neni 26a i vendimt të Eurojust-it parashikon se Eurojust-i mund të përfundojë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet kompetente të Shtete të Treta.**

Rregullorja e Eurojust-it, e miratuar në datën 14 nëntor 2018 krijon një sistem të ri qeverisjeve, qartëson marrëdhënien mes Eurojust-it dhe Zyrës së Prokurorit European, përcakton një regjim të ri për mbrojtjen e të dhenave personale, parashikon rregulla të reja për marrëdhëniet e Eurojust-it me autoritetet kompetente të vendeve të treta si dhe forcon rolin e Parlamentit European dhe të Parlamenteve Kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së në kontrollin demokratik të veprimtarisë së Eurojust-it. Rregullorja e Eurojust-it shfuqizon Vendimin e Eurojust-it me efekt nga data 12 dhjetor 2019.

4. Përfundime

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”, **nuk synon të përafrojë ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të Bashkimit European.**

Pavarësisht kësaj, ky projektligj është në përputhje me:

- **Nenin 85 të TFBE-së** që parashikon se misioni i Eurojust-it është të mbështesë dhe forcojë bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare të hetimit dhe të ndjekjes penale lidhur me krimet e rënda që prektin 2 ose më shumë Shtete Anëtare të BE-së,
- **Nenin 78 të MSA-së** që parashikon bashkëpunimin e palëve në forcimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës si dhe **nenet 82-85 të MSA-së** që parashikojnë bashkëpunimin e palëve në luftën kundër pastrimit të parave, drogave të paligjshme, terrorizmit, krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme;
- **Nenin 26a të Vendimit të Eurojusti-it** që parashikon se Eurojust-i mund të përfundojë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet kompetente të Shtete të Treta.

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit, e miratoi atë me shumicë votash

NËNKRYETARI

BLEDAR ÇUÇI